



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

F T O J

Mbledhjen e parë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më **14.04.2022** (e enjte) duke filluar në orën **13:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Aprovimi i orarit të mbledhjeve të komitetit për komunitete;
3. Diskutim dhe aprovimi i planit të punës së komitetit për komunitete;
4. Të ndryshme;

Me: 07.04.2022
Në: Novobërdë




Shqipe Mustafa
Kryesuese e Komitetit për Komunitete

Shqipe Mustafa



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë e Komitetit për Komunitete e mbajtur me: 15.03.2022g, duke filluar nga ora 11:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonović, antarët e komitetit: Dobrivoje Đorđević, Shqipe Mustafa, Violeta Milošević, Vlora Vllasaliu, Igor Vasić, Edison Jashari, Selatin Nuhiu, Nënkryetari për Komunitete Bajrush Ymeri, zv.kryesuesi Ramush Mehmeti dhe përfaqësuesi i OSCE-a.

Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonović pasi pershendeti të pranishmit konstatoj korumin, prezent janë 7 antarë të komitetit për komunitete dhe filloj mbledhjen me këtë:

Rendi i ditës

1. Zgjedhja e Kryesuesit/es të Komitetit për Komunitete;
2. Zgjedhja e zv.Kryesuesit/es të Komitetit për Komunitete;
3. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a pajtohen me këtë rend dite?

Pasi nuk pati propozime njëzëri u pajtuan për këtë rend.

Pika e parë dhe e dyta: Zgjedhja e Kryesuesit/es të Komitetit për Komunitete;

Zgjedhja e zv.Kryesuesit/es të Komitetit për Komunitete; Predsedavajuća je rekla :

Në bazë të Ligjit për Vetqeverisje Lokale dhe Rregullores 02/2011 dhe udhëzimet administrative që na kanë dhënë për komitetin për Komunitete në nenin 6 të këtij udhëzimi pika 6.1 kryesuesi dhe zv.kryesuesi i komitetit zgjedhet nga komiteti pakic nga territori i komunes.

Ndërsa në piken 6.2 kryesuesi dhe zv.kryesuesi i komitetit zgjidhen me të njëjtin mandat si antarët e komitetit. Pika 6.3 votimi për kryesues dhe zv.kryesues bëhet me votim të msheft. Pika 6.4 që kandidati të fitoj duhet të ketë shumicën e thjeshtë. Çdo antarë ka të drejtë vote, andaj pres nga ju të propozoni 2 kandidatë me paralajmërim se duhet të përfaqësohet komuniteti pakic e jo nga kandidatët e Kuvendit Komunal e kjo na i ngushton mundësitë e kandidimit pasi që mund të bëjmë dhe duhet të bëjmë dy propozime për pozitën e përmendur nga komitetet e përmendura, andaj këto dy pika i kemi bashkuar, kështu që kandidati që merr më pak vota automatikisht bëhet zv.Kryesues nese pajtoheni e në bazë të Ligjit duhet të veprojmë kështu, para se të marrë propozimet dua të pyes se a ka nevojë dikush diçka të shtoj?.

Selatin Nuhiu tha: në bazë të këtij Ligji që e lexuat dhe që duhet të veprojmë po i bije se anëtarët e Kuvendit nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në kandidaturë me automatizëm kandidati i cili është Shqipe Mustafa.

Kryesuesja tha: i falenderohem zt.Selatini, në bazë të Ligjit dhe Rregullores në teritorin e Komunës sonë i kemi tri Komunitete, pasi që Komuniteti jonë është shumic, përfaqësuesit e këtij Komuniteti skan të drejt të jenë Kryesues, kështu që na mbetin dy komunitete, ajo e shqiptarëve dhe e romëve e gjithashtu në bazë të kësaj Rregulloreje votimi duhet të jetë i msheft dhe të gjithë anëtarët kanë të drejt të votojnë, mendoj se është e domosdoshme që ti respektojnë Ligjet dhe Rregulloret që i kemi, e respektoj mendimin tuaj por më duhet ti repektoj edhe këto nene dhe Ligjin. Kështu që tani duhet ta formojm një komision.

Dobriroje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: unë kisha me thënë diçka, mendoj që për çdo komitete duhet të jetë nga një ekip e cila duhet ta pregadis rendin e ditës për mbledhjet e radhes dhe të punojnë seriozishtë e aty të jenë përfaqësuesit e të tri komuniteteve, kryesuesi të jetë prej komitetit Shqiptarë ose Romë.

Kryesuesja tha: i falenderohem zt.Djordjovic por e kemi udhëzimin administartiv dhe Ligjin dhe duhet të punojmë sipas saj, siç e dini unë si Kryesuese e Kuvendit automatiksht jam edhe Kryesuese e KPF, besoj se edhe komiteti i komuniteteve do të punoj mirë dhe me pergjegjshmeri. Kryesuesi dhe zv.Kryesuesi që ju do ta zgjidhni sot duhet të jetë nga komuniteti pakic i Komunës sonë, besoj se të gjithë ju do të keni bashkpunim të mirë të gjithë mes veti në zgjidhjen e problemeve në të cilat hasin qytetarët tonë. Andaj besoj se qytetarët do të përfaqësohen mirë në këtë komitet e më pas në KPF dhe Kuvend do ti degjojm problemet e tyre dhe do të provojm ti zgjedhim të gjitha problemet e të gjitha Komuniteteve. Të gjitha ato propozimet që i keni në komitete e që i dergoni në KPF, unë do të mundohem t'ju ndihmoj. Siç po e shihni edhe ju Ligji dhe Rregullorja e ka sqaruar këtë qështje dhe ne nuk mundë të dalim jasht tyre. Andaj kërkoj që të formojm një komision prej tre antarëve për verifikimin e zgjedhjes së Kryesuesit dhe zv.Kryesuesit.

Dobriroje Djordjevic tha: kërkoj që edhe përfqësuesi i komitetit serb të jetë pjesë e pregaditjes së komitetit të radhes, pasi që veç ai i din problemet e komitetit serb, pasi që kështu po i bie se ai nuk ka asnjë të drejt të diskutoj apo të propozoj. Unë si anëtarë i Kuvendit mundem të jap një propozim por nese një qytetarë i drejtohet një anëtar i komitetit që ai të ketëmundësi të jap atë propozim në komitet.

Kryesuesja tha: koleg ju keni qenë në përbërjen e kaluar të komitetit të komuniteteve, Kryesusi/ja e fton komitetin e komuniteteve pregadit materialin dhe gjatë mbledhjes të shtatë antarët e komitetit kanë të drejt të propozojnë pika dhe të diskutojn për qështje që janë më rëndësi dhe vendosen me shumic votash, kjo është arsyeja se pse komiteti i ka të përfaqësuar të tri Komitete e Komunës sonë. Që Kryesuesja dhe zv.Kryesuesi të mos munden pa shumicen e votave të propozojn pika. Pra çdo anëtar mund të propozoj pika dhe ta përfaqësoj komunitetin e vet. Kështu që koleg i nderuar nuk po kuptoj se si mundet komuniteti serb të jetë më pak i përfaqësuar në komitetin e komuniteteve nese në bazë të Ligjit duhet Kryesusi dhe zv.Kryesusi të zgjidhen nga komuniteti pakic.

Bajrush Ymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: gjashtë nga ju jeni të ri, ju deshiroj mirëserdhje dhe punë të sukseshme, më herët kemi pasur mirëkuptim dhe si kemi pasur këto probleme që do duhej ti kemi edhe tani do të kishte qenë mirë që të kalojm në piken e rendit të ditës e di se Rregullorja e parasheh votimin e msheft por mendoj se do duhej të shkojm me votim të hapur për Kryesus dhe zv.kryesus, por nese doni të votoni me votim të msheft, atëher ti marrim propozimet dhe të vazhdojm me punë. Kryesusi/ja e këtij komiteti normal se do ta marr edhe vendimin e juaj rreth pikave, ju të gjithë keni të drejt ta kontaktoni zyren e kuvendit dhe ti propozni interesat e komunitetit tuaj. Unë nuk po shoh se ka ndonjë problem dhe ky komitet është i obligueshem. Prasndaj e lus Kryesuesen e Kuvendit që bisedat që po bëhen këtu të mirren parasysh nga organet e Kuvendit. Gjithmonë do ta keni përkrahjen time pasi që LVK e parasheh që Nënkryetari për Komunitete, zv.kryesusi, shefja e ZKK dhe kryesuesi/ja e komiteteve duhet ngusht të bashkpunojn rreth takimeve tuaja dhe qështjeve që janë në interes, kështu që nga ana jonë do ta keni përkrahjen dhe sdo të keni probleme.

Kryesuesja tha: i falenderohem Nënkryetarit për komunitete për këto fjalë mirëpo unë do ti qendroj besnike vendimit që të kemi votim të msheft, andaj ju lus ti popozojm tre anëtarë për komision:
Selatin Nuhiu e propozoi Dobrivoje Djordjevic
Vlora Vllasalaiu propozoi Selatin Nuhiu
Dobrivoje Djorjevic propozoi Vlora Vllasaliu

FORMOHET komisioni nga tre anëtare për verifikim e votimit:

1. Dobrivoje Djordjevic
2. Selatin Nuhiu
3. Vlora Vllasaliu

Kandidatët : Shqipe Mustafa dhe Edison Jashari.

Kryesusja e dha një pauz prej 10min. deri sa administarta e Kuvendit ti pregadit fletvotimet. Pas pauzes prej 10min u konstatua se anëtari i tretë nuk është prezent, kështu që anëtarët e komiteti janë të obliguar të zgjedhin një anëtar tjetër ku në propozimin e Igor Vasiç u zgjodh Violeta Milosevic si anëtare e komisionit.

Të gjithë anëtarët e komitetit votuan me rend.

Pas përfundimit të votimit të msheft dhe numërimit të votave Kryesuesja tha: pasi që e përfunduam votimin e msheft ashtu siç e parasheh Ligji çdo njëri prej juve e ka shpreh vullnetin e vet se kend do ta zgjedh për Kryesuese të Komitetit me 5 vota për do ti uroja znj.Shqipe Mustafa, shpresoj dhe besoj se si Kryesuse do ta udhëheq këtë komitet dhe do ti përfaqësoj të tri komitete dhe çdo anëtar i komitetit të ketë të drejten të paraqes ndonjë breng dhe problem për komitetin e vet si dhe të gjithë të jenë të barabartë. Siç mundeni edhe vet ta vëreni në Komunën tonë po respektohet edhe Ligji për Barazi Gjimore kemi mjaft femra që janë në pozitata që mundë të vendosin, andaj besoj se edhe ju do të jeni në pozitën udhëheqëse dhe ta kryeni punën tuaj pa ndikime në interes të Komunës suaj. Gjithashtu ju uroj suksese në punë edhe zv.Kryesusit Edison jasharit, dhe besoj se edhe ju si përfaqësues i komunitetit rom do ta jepni kontributin tuaj, dhe të përfaqësoni komunitetin tuaj më së miri. Të gjithë juve edhe njëher dua tju them se dyert e Kuvendit janë të hapuara për ju për çfar do teme diskutimi apo problem. Ky komitet është i rëndësishëm për Komunën tonë duke pas parasysh se i kemi dy komitete obligative, pra KPF dhe komitetin e komuniteteve, ju uroj edhe njëher dhe tani ju jap fjalën Kryesues së Komitetit znj.Shqipe Mustafa.

Shqipe Mustafa: i falenderohem Kryesueses së Kuvendit, i nderuari Nënkryetar, të nderuar anëtarë të komitetit, përfaqësues të OSBE-së dhe të pranishëm të tjerë, ju faleminderit që ma keni zgjedhur ta udhëheq këtë komitete si dhe që më keni votuar, besoj se do të keni bashkpunim të mirë këtu të gjithë së bashku në këtë tryez gjatë punës son ti paraqesim problemet dhe nevojat e të gjithë qytetarëve pamvarsisht se cilit komitet i takojnë, gjithashtu besoj se ju si Kuvend ti mirrni parasysh kërkesat tona, pasi që kjo është hera e parë që po marrë pjesë në këtë lloj takimi shpresoj të bashkpunojm dhe besoj se do të jemi në kontakt që tja propozoj edhe planin e punës dhe aktivitete tona tjera.

Edison Jashari tha: po i pershendes të pranishmit dhe si përfaqësues i komunitetit rom do të mundohem të përfaqësoj komunitetin Rom në mënyrë profesionale, edhe unë për herë të parë jamë në këto takime, dëshiroj të uroj kolegen për pozitën e Kryesueses dhe shpresoj se do ti zgjedhim problemet së bashku që i kemi në këto takimet tona.


Pika e tretë: të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit tha: a ka edhe dikush diqka të shtoj?.

Bajrush Ymeri tha: po e uroj znj.Shqipe dhe zt.Edisoni t'ju uroj punë të mbarë dhe tju them se e keni përkrahjen tonë, atë që deshta të them është se ky komitet është i lidhur edhe më tri mekanizma tjerë të Komunës, nënkryetarin e Komuniteteve, zv.kryesuesin e komuniteteve dhe shefin e ZKKK, ne do të jemi këtu që t'ju ndihmojm dhe tju lehtojm punën. Në rrugëtimin tim politik nga viti 2002-2007 unë e kam udhëhequr komitetin e komuniteteve po ju permendi edhe njëher se do të jemi këtu dhe do tju ndihmojm për çdo gjë, po e lus edhe njëher kryesuesen e Kuvendit që ti merr parasysh të gjitha ato që vin nga komitetit i komuniteteve që anëtarët e këtij komiteti të nihen mirë dhe të kenë vullnet për mbajtjen e këtyre mbledhjeve.

Pasi nuk pati diskutime tjera kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në 12:20h.

Andjela Stojkovic
Procesmbajtese



Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

DATE/A:	06.04.2022
PËR/ZA/TO:	Antarët e Komitetit për Komunitete
NGA/OD/FROM:	Shqipe Mustafa – Kryesuese e Komitetit për Komunitete
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit për vitin 2022

Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit po ju dërgoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit për Komunitete për vitin 2022

Nr	Dita	Data	Koha	Vendi
1.	E enjte	14.04.2022	13:00	Salla e Kuvendit Komunal
2.	E enjte	12.05.2022	13:00	Salla e Kuvendit Komunal
3.	E hënë	13.06.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
4.	E mërkurë	13.07.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
5.	E mërkurë	14.09.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
6.	E enjte	13.10.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
7.	E hënë	14.11.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
8.	E enjte	15.12.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE-MUNICIPAL ASSEMBLY

DATE/A:	06.04.2022
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Komitetit për Komunitete
NGA/OD/FROM:	Shqipe Mustafa-Kryesuese e Komitetit për Komunitete
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i punës së Komitetit për Komunitete

Plani i punës së Komitetit për Komunitete të Komunës së Novobërdës për vitin 2022

Prill

Aktiviteti	Qëllimi	Rezultatet	Muaji/Java
Orari i mbledhjeve të komitetit për komunitete	Diskutim rreth orarit të mbledhjeve të komitetit për komunitete	Aprovimi i orarit të mbledhjeve	Java e dytë
Plani i punës së komitetit për komunitete	Diskutim me anëtarë të komitetit për planin e punës së komitetit	Aprovim i planit të punës së komitetit për komunitete	Java e dytë

Maj

Aktiviteti	Qëllimi	Rezultatet	Muaji/Java
Pjesëmarrja në mbledhjen e KPF-së dhe mbledhjen e Kuvendit Komunal	Shqyrtimi i rregulloreve	Pjesëmarrja në proceset e marrjes së vendimeve	
Aktivitete të Komitetit për komunitete në komunitet	-Pranimi i ankesave të qytetarëve	Kontakte me qytetarë dhe marrja e informacioneve	
Takim pune me kryetarin e komunës dhe kryesuesin e kuvendit	Diskutim rreth çështjeve aktuale	Takime të rregullta me qëllim bashkëpunimi	Java e dytë
Takim pune me drejtorin e shëndetësisë	Diskutim rreth gjendjes në ambulantat e komunës	Njoftim i komitetit për gjendjen në shëndetësi	Java e dytë
Takim pune me drejtorin e financave	Diskutim rreth procedurave për fillim të hartimit të buxhetit të vitit 2023	Njoftim i komitetit me procedurat e fillimit të hartimit të buxhetit të vitit 2023	Java e dytë
Takimi i Komitetit për Komunitete	Njoftim nga zyra për komunitete dhe kthim		Java e dytë

Qershor

Aktiviteti	Qëllimi	Rezultatet	Muaji/Java
Pjesëmarrja në mbledhjen e KPF-së dhe mbledhjen e Kuvendit Komunal	Shqyrtimi i rregulloreve	Pjesëmarrja në proceset e marrjes së vendimeve	
Takim pune me kryetarin e komunës dhe kryesuesin e kuvendit	Diskutim rreth çështjeve aktuale	Takime të rregullta me qëllim bashkëpunimi	Java e dytë
Takim pune me drejtorin e shërbimeve publike	Diskutim rreth gjendjes së ambientit në teritorin e komunës	Njoftim i komitetit për gjendjen e ambientit në teritorin e komunës	Java e dytë
Takimi i Komitetit për Komunitete	Njoftim nga zyra për komunitete dhe kthim		Java e dytë

Korrik

Aktiviteti	Qëllimi	Rezultatet	Muaji/Java
Pjesëmarrja në mbledhjen e KPF-së dhe Mbledhjen e Kuvendit Komunal	Shqyrtimi i rregulloreve	Pjesëmarrja në proceset e marrjes së vendimeve	
Takim pune me kryetarin e komunës dhe kryesuesin e kuvendit	Diskutim rreth çështjeve aktuale	Takime të rregullta me qëllim bashkëpunimi	Java e dytë
Takim pune me drejtorin e arsimit	Njoftim rreth përfundimit të vitit shkollor 2021/22	Njoftim i komitetit rreth përfundimit të vitit shkollor 2021/22	Java e dytë
Takim pune me drejtorin e bujqësisë	diskutim rreth përfundimit të korrje-shirjeve	Njoftim i komitetit me përfundimin e korrje-shirjeve	
Takimi i Komitetit për Komunitete	Njoftim nga zyra për komunitete dhe kthim		Java e dytë

Shtator

Aktiviteti	Qëllimi	Rezultatet	Muaji/Java
Pjesëmarrja në mbledhjen e KPF-së dhe mbledhjen e Kuvendit Komunal	Shqyrtimi i rregulloreve	Pjesëmarrja në proceset e marrjes së vendimeve	
Takim pune me komitetet e komunave tjera	Informim dhe shkëmbim i përvojave më të mira	-Ide të reja -Shkëmbim i informatave -Krijim i kontakteve	Java e dytë
Takim pune me drejtorin e financave	Diskutim buxhetit të vitit 2023	Njoftim i komitetit me buxhetin të vitit 2023	Java e dytë
Takimi i Komitetit për Komunitete	Njoftim nga zyra për komunitete dhe kthim		Java e dytë

Tetor

Aktiviteti	Qëllimi	Rezultatet	Muaji/Java
Pjesëmarrja në mbledhjen e KPF-së dhe mbledhjen e Kuvendit Komunal	Shqyrtimi i rregulloreve	Pjesëmarrja në proceset e marrjes së vendimeve	
Aktivitete të Komitetit për komunitete në komunitet	-Pranimi i ankesave të qytetarëve		Java e dytë
Takim pune me drejtorin e arsimit	Njoftim rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2022/23	Njoftim i komitetit rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2022/23	
Takimi i Komitetit për Komunitete	Njoftim nga zyra për komunitete dhe kthim		Java e dytë

Nëntor

Aktiviteti	Qëllimi	Rezultatet	Muaji/Java
Pjesëmarrja në mbledhjen e KPF-së dhe mbledhjen e Kuvendit Komunal	Shqyrtimi i rregulloreve	Pjesëmarrja në proceset e marrjes së vendimeve	
Aktivitete të Komitetit për komunitete në komunitet	-Pranimi i ankesave të qytetarëve	Kontakte me qytetarë dhe marrja e informacioneve	Java e dytë
Takim pune me kryetarin e komunës dhe kryesuesin e kuvendit	Diskutim rreth çështjeve aktuale	Takime të rregullta me qëllim bashkëpunimi	Java e dytë
Takimi i Komitetit për Komunitete	Njoftim nga zyra për komunitete dhe kthim		Java e dytë

Dhjetor

Aktiviteti	Qëllimi	Rezultatet	Muaji/Java
Pjesëmarrja në mbledhjen e KPF-së dhe mbledhjen e Kuvendit Komunal	Shqyrtimi i rregulloreve	Pjesëmarrja në proceset e marrjes së vendimeve	
Aktivitete të Komitetit për komunitete në komunitet	-Pranimi i ankesave të qytetarëve	Kontakte me qytetarë dhe marrja e informacioneve	
Raporti vjetor mbi punën e Komitetit për Komunitete	Njoftim i anëtarëve të Komitetit dhe Kuvendit Komunal me punën e Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2022	Informimi i anëtarëve të Komitetit dhe Kuvendit Komunal me punën e Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2022	Java e dytë
Takimi i Komitetit për Komunitete	Njoftim nga zyra për komunitete dhe kthim		Java e dytë

Në Novobërdë
Më 06.04.2022

Shqipe Mustafa
Kryesuese e Komitetit për Komunitete
